



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 3996 / prot. 1

Tiranë, më 31.07.2024

URDHËR

Nr. 192, datë 31.07.2024

PËR
GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE TË NGUTSHME NË PERIUDHËN E PUSHIMEVE
VJETORE

Në mbështetje të shkronjës "i" të nenit 37 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 23 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Çështjet dhe kërkesat procedurale me natyrë të ngutshme, të shortuara dhe të shpallura për gjykim para hyrjes në fuqi të urdhrit nr. 186, datë 30.07.2024 "Për dhënien e pushimit vjetor për vitin 2024", por gjykimi i të cilave nuk ka përfunduar, të vijojnë të gjykohen në muajin gusht 2024.
2. Gjyqtarët që bëjnë pjesë në trupat gjyqësore të ngarkuar për gjykimin e çështjeve dhe kërkesave procedurale me natyrë të ngutshme si dhe këshilltarët ligjorë të ngarkuar me studimin e tyre, nëse pjesëmarrja e tyre çmohet e nevojshme nga gjyqtari relator, të ndërpresin pushimet vjetore në ditët e caktuara për gjykimin e tyre.
3. Ditët e pushimeve vjetore në të cilat gjyqtarët kanë gjykuar çështjet dhe kërkesat procedurale të ngutshme si dhe këshilltarët ligjorë përkatës sipas këtij urdhri, të zëvendësohen në një periudhë tjetër sipas kërkesës së gjyqtarit/këshilltarit ligjor dhe parashikimeve ligjore.
4. Ky urdhër t'i njoftohet gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë, Kancelarit dhe Kryesekretarit.

Ku urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
SOKOL SADUSHI

